



www.pkjuboten.org.mk

kontakt@pkjuboten.org.mk

ul. „K.J. Pitu“ br.6, Tetovo R.S Makedonija

FTESË NGJITJA TRADICIONALE E 41-tË NË “MAJËN E TITOS” (“TITOV VRV”) 2023

Klubi i bjeshkatarëve „Luboten“ – Tetovë për të 41-tën herë organizon ngjitjen tradicionale në Majën e Titos (Titov Vrv), e cila vetvetiu ndër vite u bë markë malore në Republikën e Maqedonisë. Me manifestime të tilla, vendi jonë krijon traditë e cila zgjat dhe na përfaqëson në suaza ndërkombëtare, duke theksuar kujdesin për shëndetin dhe mirëqenien e popullatës, mbrojtjen e natyrës dhe synimin drejt një jete të qëndrueshme dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Manifestimi është pjesë e kalendarit të ngjarjeve të UE delegacionit në Shkup

Me qëllim që të ruhet një nivel i lartë i sigurisë dhe organizimit, në përputhje me rekomandimet e FSAM – Federata e Sporteve të Alpinizmit në Maqedoni për “Organizimin e aksioneve të mëdha tradicionale të alpinizmit”, Klubi i bjeshkatarëve “Luboten” u bën ftesë të gjitha shoqatave/klubeve dhe shoqërive të organizuara të marrin pjesë në këtë ngjarje të përbashkët të bjeshkatarëve. Të gjitha shoqatat/klubet dhe shoqëritë e organizuara duhet detyrimisht të aplikojnë nëpërmjet fletëparaqitjes dhe deklaratës së koordinatorit (në shtojcë), me çka do të fitonin statusin e pjesëmarrësit në aktivitetin e organizuar.

INFORMACIONE PËR VENDOSJEN DHE TRANSPORTIN

- Transporti deri në Kodrën e Diellit është në organizimin personal
- Fjetja është e siguar në:
 - Hotel Sllavija – Kodra e Diellit, me çmim prej 900 den. (15 €) për natë
 - Hotel Teteks – Kodra e Diellit, me çmim prej 1 800 den. (30 €) për gjysmë pansion (HB)
- Ju lutemi, që në kohën dhe **më së voni deri më 23.05.2023 ta paraqitni pjesëmarrjen tuaj**, që të mund të bëjmë koordinimin e vendosjes në kapacitetet e siguruara të vendosjes. (për informacione shtesë ju qëndrojmë në dispozicion)

KONTAKTE për informata

- Igor Stojanoski – mob.: **+389 (0) 77 894 661**
- Despina Tofilovska – mob. **+389 (0) 77 592 091**
- e-mail: kontakt@pkjuboten.org.mk



www.pkjuboten.org.mk

kontakt@pkjuboten.org.mk

ul. „K.J. Pitu“ br.6, Tetovo R.S Makedonija

PROGRAMI I AKTIVITETIT

27 maj 2023 (e shtunë):

- 11:00 – 18:00 – pranimi i mysafirëve në hotel “Slavija” – Kodra e Diellit

Aktivitete:

- aksion për pastrim 13:00 – 14:00
 - shitje bamirësie 15:00 – 20:00
 - kuizi i njohurive bjeshkatore 15:30 – 17:00
 - projektimi i filmit 17:30 – 18:30
- 19:00 – hapja solemne e manifestimit në hyrjen e hotelit “**Slavija**” – Kodra e Diellit.
 - 19:30 – mbledhje me koordinatorët e grupeve në të cilën në hollësi do të sqarohen kushtet për ngjitje dhe ndarja të diplomave për pjesëmarrje
 - 20:00 – 23:00 - shoqërim i bjeshkatarëve dhe aheng

28 maj 2023 (e diell):

- 06:30 – nisja e kolonës nga hapësira para hotelit “Kodra e Diellit” për në Majën e Titos përmes „Rrugës së Vakëfit“!
- 11:00 – arritja e kolonës në Majën e Titos.
- 12:00 – nisja e kolonës nga Maja e Titos drejt Kodrës së Diellit.
- 16:00 – mbërritja në Kodrën e Diellit, shërbimi me çaj mali, e organizuar nga “**Miqtë ë Sharrit**”, aheng me dixhej dhe shtande të hapura me prodhime vendore
- 18:00 - përcjellja e pjesëmarrësve dhe mbyllja e manifestimit.

PARAQITJA

Paraqitja mund të bëhet:

- Duke na dërguar formularë origjinalë të skanuar dhe deklarata (në shtojcë), në adresën zyrtare elektronike të K.B. Luboten - kontakt@pkjuboten.org.mk, më së voni deri më datën **23.05.2023, deri në orën 19:00** dhe me dorëzimin e formularëve origjinalë të plotësuar gjatë arritjes të shoqatave/klubeve dhe shoqërive të organizuara në kapacitetet e vendosjes më **26.05.2023, deri në orën 18:00** ose
- Me plotësimin e formularëve dhe deklaratave me mbërritjen e shoqatave/klubeve dhe shoqërive të organizuara në kapacitetet e vendosjes më **26.05.2023, deri në orën 18:00**.
- Paraqitja bëhet me qëllim që të verifikohet pjesëmarrja në ngjitjen e tradicionale të 41-të “Maja e Titos 2023” të shoqatave/klubeve dhe shoqërive të organizuara dhe ndarjes së diplomave për pjesëmarrje.



www.pkjuboten.org.mk

kontakt@pkjuboten.org.mk

ul. „K.J. Pitu“ br.6, Tetovo R.S Makedonija

ORGANIZIMI I NGJITJES

- Lëvizja bëhet nëpër Rugën e Vakëfit në kolonë të organizuar sipas programit të theksuar!
- GPS të dhënat për shtegun, ua dorëzojmë si shtojcë!
- Koordinatorët e shoqatave/klubeve dhe shoqërive të organizuara, detyrimisht duhet të jenë të pranishëm në takimin me koordinatorët!
- Koordinatorët e shoqatave/klubeve dhe shoqërive të organizuara janë përgjegjës për anëtarët e paraqitur nga klubi amë dhe secili koordinator duhet të ketë siguruar numër të mjaftueshëm të udhërrëfyesve në përputhje me numrin e paraqitur të pjesëmarrësve nga klubet amë – në përputhje me rekomandimet të FSAM-it („*udhëzim për numrin e pjesëmarrësve në aksionin bjeshkatarë për udhërrëfyes bjeshkatarësh*“)
- Ushqimi është në regjinë personale, e paraparë në mënyrë individuale për turn bjeshkatarë deri në 10 orë!
- Për t'u ngjitur nevojitet pajisje përkatëse të bjeshkatarëve për kushte të dimrit!
- Secili prej pjesëmarrësve duhet të jetë në kondicion të mirë shëndetësor dhe psikofizik!
- Të gjithë personat që dëshirojnë të marrin pjesë në këtë manifestim duhet t'i bashkëngjiten ndonjë shoqate/klubi dhe shoqërie të organizuar me një fletëparaqitje formale!
- Organizatori e ruan të drejtë për ndryshim të programit varësisht prej kushteve atmosferike!

REKOMANDIMET E FSAM-it

Të gjithë pjesëmarrësit janë të obliguar t'u përmbahen rekomandimeve vijuese:

- „Lëvizje nëpër mal në kushte dimërore“ ([lidhja me dokumentin](#))
- „Rekomandime për pajisje“ ([lidhje me dokumentin](#))
- „Vizitë e sigurt në male në dimër bëhuni të përgatitur dhe të përgjegjshëm“ ([lidhja me dokumentin](#))
- „Kodeksi për nderin e bjeshkatarëve maqedonas“ ([lidhja me dokumentin](#))

Vërejtje: Klubi i bjeshkatarëve „Luboten“ nuk është përgjegjës për pasojat që mund të ndodhin jashtë këtij program, si dhe për pjesëmarrësit që nuk kanë dorëzuar deklarata dhe formular për paraqitje! **Të gjitha shoqatat/klubet dhe shoqëritë e organizuara formale dhe pjesëmarrësit individualë llogaritet se nuk janë pjesë e organizimit, ngjitja e 41-të tradicionale “Maja e Titos 2023”.**